



# 2013

## RAPORT- TM<sub>4</sub> -2013




K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

[www.hr-jugor.com](http://www.hr-jugor.com)

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>2</b>
<b>Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”</b>	<b>3</b>
<b>I. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK</b>	<b>4</b>
1.1 Aktivitetet – Tetor-Dhjetor 2013	4
1.2 Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike	7
1.3 Planifikimi I investimeve emergjente	7
1.4 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	8
1.5 Zyra për planifikim dhe zhvillim	8
1.6 Servisimi I ujëmatësve	10
1.7 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	11
<b>II. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË</b>	<b>17</b>
2.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	17
2.2 Pengesat në realizimin e objektivave	19
2.3 Planet për të ardhmen	19
2.4 Aktivitetet e shërbimit për informim	20
<b>III. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV</b>	<b>23</b>
3.1 Aktivitetet - Tetor- Dhjetor 2013	23
3.2 Personeli	25
3.3 Raport I zyrës ligjore	26
3.4 Aktivitetet e zyrës së Teknologjisë Informativë	30
<b>IV. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR</b>	<b>33</b>
4.1 Aktivitetet - Tetor-Dhjetor 2013	33
4.2 Raport I performances financiare- TM <sub>3</sub> -TM <sub>4</sub> - 2013	35
<b>V. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM</b>	<b>40</b>
<b>Shtesa I: Raporti I investimeve</b>	

## ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



## I. SHËRBIMI TEKNIK

### 1.1 Aktivitetet – Tetor-Dhjetor 2013

#### Furnizimi

Edhe pse prurjet e ujit në burimet e vjetra me gravitet kanë rënie të madhe, por falë shtimit të kapaciteteve të reja të ujit në lokacioni e „40 Burimet“ kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë për të gjithë qytetin e Prizrenit duke u furnizuar nga pusët e reja (tek 40 burimet) dhe shpimet i tri puse tek objektet e vjetra të „Hidroregjioni jugor“ në Prizren, shpimet e puseve të reja janë realizuar me qellim për t'i zëvendësuar humbjet nga burimet e vjetra.

Kompania është angazhuar dhe ja ka arritur që në TM-4 te vitit 2013 të furnizojë të gjithë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku dhe kemi reduktime të shkurtra brenda ditës ( *Kryesisht Lagja Dardania*). Në Njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragashë nuk ka pas probleme me furnizim me ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e Njësite Operuese kemi pas furnizim pa ndërprerje me ujë të pijes.

#### Uji i prodhuar

Për e TM-4 vitit 2013 në nivel regjional janë raportuar prodhim te ujit. **4,398,697.00 m<sup>3</sup>** krahasuar me TM-3 kemi një rrënje te prodhimit te ujit te pijes prej **1,057,275.00 m<sup>3</sup>**, (kjo rënie paraqitet si arsytim i rënieve të burimeve të vjetra) mirëpo KRU „Hidroregjioni Jugor“ ka shtuar aktivitetet dhe ka siguruar burime te reja të ujit të pijes, dhe injektimin e kësaj sasive ne rrjetin shpërndarës.

#### Uji i pa faturuar

UPF vazhdon te mbetet një sfidë kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim më të gjitha shërbimet si dhe duke ju falënderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar shumë aktivitete kryesisht në zvogëlimin e UPF-se.

Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPF-se qe nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në tërësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektorët e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e tyre sa më të shpejtë. Kompania është duke i vazhduar aktivitetet për zvogëlimin e UPF-se dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Është formuar grupi i veçantë brenda Departamentit Teknik për verifikimin e rrjetit shpërndarës dhe verifikimin e valvuleve në qytetin e Prizrenit. Deri më tani është verifikuar rrjeti shpërndarës si dhe janë duke i bërë analizat nëpër zonat e furnizimit.

Raportet tregojnë se UPF në nivel regjional për TM-4 është **59.63 %** ose **0.44%** më shumë humbje nga TM-3.

## Aktivitetet - Tetor-Nëntor-Dhjetor / 2013

Aktivitetet e shërbimit Teknik ne nivel regjional kanë qene te pareshtura dhe janë orientuar ne mundësinë e furnizimit sa me te rregullt me ujë te pijes për te gjithë konsumatorët qe kjo kompani i mbulon, si dhe ne aktivitetet teknike për uljen e humbjeve si atyre teknike po ashtu dhe atyre administrative respektivisht uljen e vlerave te UPF-se.

\*Duke u bazuar ne raportet e prodhimit te ujit niveli i ujit ne burime e vjetra ka pasur rënie te dukshëm, si pasojë jemi te detyruar te bëjmë hulumtime të reja për shpime për t'i zëvendësuar humbjet në burimet ekzistuese.

\*Aktivitetet në periudhën e TM-4 vetëm në Njësinë e Prizrenit kemi pas 284 intervenime ne rrjetin sekondar si dhe në 60 intervenime në rrjetin primar, te cilat kanë ndikuar dukshëm edhe ne furnizim te rregullt në njësinë e Prizrenit.

\*Gjatë kësaj periudhe TM-4 kemi pasur furnizim te qytetarëve me ujë edhe përmes cisternës në ato vende ku ka pasur defekte ose mungesë të ujit.

\*Aktiviteti i në këtë TM-4 është edhe realizimi i punimeve te 40 Burimet duke bërë shtrirje e gypit  $\Phi$  315 me gjatësi mbi 250 metra duke realizuar shtimin e sasisë së ujit nga komora e ujëmbledhësit deri tek injektimi në gypin  $\Phi$  600 mm.

Vlera për realizimin hynë në kuadër të projektit „Pastrimi i Lumit Bistrica në Prizren“ projekt i cili është financuar nga MMPH, MZHE dhe nga kompania e HRJ në Prizren.

Sasia- distanca e shtrirjes së gypit është 250 metra me diametër  $\Phi$  315

Vendi – shtrirja e gypit prej 40 burimeve ne drejtim të hyrjes të qytetit të Prizrenit

\* Nga komuna e Prizrenit jemi ne procedure te rregullimit te dokumentacionit përkatës, ku ne Drejtorinë e Shërbimeve Publike është lëshuar një pëlqim për mundësinë e manovrimeve teknike te cilat kane te bëjnë me projektin, kurse nga Drejtoria e Urbanizimit janë lëshuar kushtet urbanistike te cilat duhet te plotësohen dhe është marre leja e influentit për ujëra te zeza.

\*Kohë me parë nga MZHE janë nënshkruar dy marrëveshje për te financuar projektin për ndërtimin e rezervarit tek lokacioni “Krismat e Sali Shabanit” në Baqevc – Suharekë me shumën prej 500.000 € , si dhe është nënshkruar edhe marrëveshja për rrugën e „Muhagjerve“ me shumën prej 119.000€ projekt u cili ka përfunduar, kurse projekti i rezervuarëve është në vazhdim.( ekziston raport i veçantë nga Ndjesia e Suharekës)

\*Takim me përfaqësuesit e ZRRUK-ut lidhur me nënshkrimin e një marrëveshje për plotësimin e standardeve për furnizim me ujë për lagjen e Dardanisë me qellim qe lirohemi nga performanca për 600 konsumator të kësaj lagje.

\* Takime të menagjmentit me banoret e lagjes Dardania për furnizim më të rregullt me ujë, gjatë takimit kemi biseduar për eliminimin reduktiveve duhet të bëhet grumbullimin e 50 % borxheve dhe për shumën e grumbulluar do të kthehet në investim, me ndërtimin e një rezervari si dhe instalimi i gypit furnizues nga rezervari deri te sistemi ekzistues, ky projekt ende nuk është realizuar për shkak se konsumatorët e kësaj lagje nuk po i përgjigjen marrëveshjes për pagesën e obligimeve ndaj kompanisë.

\* Në takim me menaxhmentin e „Hidroregjionit“ jemi rakorduar për shkak të keqpërdorimit të ujit të pijes nga disa konsumatorë, lagje ose fshatë të mos ketë furnizimi të rregullt me ujë të pijes aty ku humbjet janë të mëdha në baze të matjeve nga ujëmatësit zonal, këto zona do të aplikohen në të gjithë regjionin e Prizrenit.

\* Kohe me parë është nënshkruar Marrëveshja me përfaqësuesit e fsh. Kabashë, HRJ si dhe nga Kryetari i Komunës së Prizrenit. Nga kjo marrëveshje sistemi i ujit të pijes kalon nën menaxhimin e Hidroregjionit jugor, ku ekipet tona e kanë verifikuar gjendjen e ujësjellësit dhe të kanalizimeve në fshatë si dhe kanë bërë instalimin dhe bllobimin e ujëmatësve të të gjithë konsumatorëve.

\* Në TM-4 janë bërë vazhdimi i shpime të puseve në fsh. Sallagrazhd për furnizimi me ujë qytetaret e komunës së Suharekës dhe jemi në vazhdim të hulumtimeve të puseve tjera me qëllim që furnizim me ujë të jetë i mjaftueshëm për qytetarët e Suharekës dhe fshatrat për rreth.

Vlera e projektit deri tani- 650 mijë euro, projekti vazhdon

Sasia e ujit që parashihet të sigurohet – 150 l/s

Vendi – Baçevc “Krismat e Sali Shabanit”

Investitori – Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Komuna e Suharekës

\* Nga Departamenti Teknik janë plotësuar dokumentacionet e nevojshme për Pëlqimet-Lejet përkatëse të cilat janë dërguar në MMPH dhe në Komunën e Prizrenit për projektin Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave të Zeza. Pasi që lidhur me lejet përkatëse për ndërtimin e ITUZ-se , janë dy institucionet përgjegjëse:

- ✚ Ministria përgjegjëse për çështjet mjedisore që lejon projektimin, sistemin dhe shkallën e procesit të trajtimit, dhe
- ✚ Komuna e Prizrenit e cila për rehabilitimin dhe ndërtimin e dy kolektorëve si dhe ndërtimin e ITUZ-se do të jep lejen përkatëse.

\* Sa i përket Projektit Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave të Zeza, Kompania P2M dhe ajo vendore Alb-Architect janë në bashkëpunim me Stafin Teknik të HRJ-se duke grumbulluar informacione teknike dhe administrative të cilat do të ndikojnë në mbarëvajtjen e projektit.

\* Në këtë TM-4 kemi pas takimit me Kryetarin e Dragashit si dhe jemi akorduar të bëhet përgatitja për nënshkrimin e marrëveshjes për fsh. Brezne që të kalohet nën menaxhimin e Hidroregjionit, andaj ekipet tona kanë verifikuar gjendjen reale të ujësjellësit dhe pritet se shpejtë të bëhet nënshkrimi i marrëveshjes.

\* Janë mbajtur takime të vazhdueshme me përfaqësues të fshatit Brezne dhe zyrtar të Kuvendit Komunal për marrjen në menaxhim të fshatit Brezne si dhe është verifikuar gjendja ekzistuese e ujësjellësit të fshatit Brezne, ujësjellës ky i cili në muajin dhjetor është vënë në funksion me ndihmën e donatorëve dhe Kuvendit Komunal në Dragash.

\* Në muajin Dhjetor janë bërë vazhdimi i punimeve për ndërtimin e dy rezervuarve për furnizim me ujë për qytetarët e komunës së Suharekës dhe deri më tani janë bërë hapja e a kanaleve dhe shtrirja e gypave deri tek rezervarët.



\* Departamenti teknik ka bërë të gjitha përgatitjet për të zgjidhur problemin e ujit të pijes për qytetin e Prizrenit dhe ka bërë projekte ideore dhe shumën e përafërt, me qëllim që këto projekte ideore ti prezantohen në një të ardhme asamblesë komunale në Prizren.

\*Gjatë periudhës së TM-4 janë bërë shpime të tri puseve tek objektet e vjetra të kompanisë sonë me qëllim që të ketë furnizim me të rregullt për qytetaret e Prizrenit e sidomos për pjesën e Tususit.

\* Në TM-4 janë bërë leximet e ujëmatësve zonal për çdo muaj me qëllim për të verifikuar shpenzimet e ujit nëpër zonat e veçanta.

## 1.2 Aktivitet e shërbimit teknik për eliminimin e humbjeve teknike

- ✚ Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale,
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – detektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për detektim.
- ✚ Sensibilizimin e të gjithë konsumatoreve për mos keqpërdorim të ujit të pijes përmes, fletëpalosjeve, informatave medieve elektronike dhe atyre të shkruara,
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet argëtimi dhe të kemi mbëlueshmëri financiare e cila do të kthehet konsumatoreve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

## 1.3 Planifikimi i investimeve emergjente të kompanisë për përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë të pijes

\* Implementimi i projektit kryesor „40 Burimet“ i cili parasheh:

\* Ndërtimin e Komores ujëmbledhëse dhe injektimin e sasisë së re të ujit të pijes në rrjetin distributiv të qytetit të Prizrenit. Është përpiluar projekti ideor i ndërtimit të galerisë përcjellëse dhe ndërtimi i komores kryesore i cili për të realizuar arrin vlerën e përafërt prej rreth 180,000.00 €, dhe hulumtimi dhe kaptimi i burimeve ekzistuese në afërsi të kaptazhes së IV-te i cili kap vlerën prej 220,000.00€.

\* Vendosjen e linjës së veçante nga Marashi deri tek ETC-ja që pareshe ndarjen e zonave të furnizimit. Ndarjen e furnizimit të fshatrave dhe lagjes Bajram Curri nga rrjeti furnizues i qytetit, nga departamenti teknik është hartuar projekti i cili kap vlerën e përafërt prej 196,000.00 €.

\* Kompania HIDROREGJIONI JUGOR në Planin e Biznesit dhe në Strategjinë Zhvillimore ka planifikuar edhe planin afatgjatë të investimeve për ujësjellës dhe kanalizim.

\* Në bashkëpunim me K. e Prizrenit kemi hartuar planin investiv për ujë dhe kanalizim në të cilin kemi paraqitur planin dhe dinamikën e përfundimit të këtyre punimeve me të cilat planifikojmë të zgjidhim përfundimisht furnizimin 24 orësh me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët e regjionit të Prizrenit ku kjo kompani i mbulon. \* Zgjerimi i veprimtarisë së Kompanisë për marrjen e sistemeve Rurale nën menaxhimin e HRJ-se.

Kompania ka përpiluar hartat me mbëlueshmëri të cilat i bashkëngjiten këtij raporti.

### Prodhimi i ujit m<sup>3</sup> TM-4 / 2013

Muaji	Prodhimi mujor m <sup>3</sup>	Prodhimi ditor- m <sup>3</sup>	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,437,810.00	37,367.50	432.5	
Suharekë	503,840.00	5,476.52	63.4	
Dragash	109,500.00	1,190.22	13.8	
Malishevë	347,547.00	3,777.68	43.7	
<b>Total</b>	<b>4,398,697.00</b>	<b>47,811.92</b>	<b>553.4</b>	

### Mirëmbajtja e rrjetit- Sanimi i defekteve TM-3, 2013

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	324	98	422
Suharekë	92	15	107
Dragash	02	0	2
Malishevë	41	11	52
<b>Total</b>	<b>459</b>	<b>124</b>	<b>583</b>

### 1.4 MIRËMBAJTJA E RRJETIT – SANIMI I DEFEKTEVE - TM-4 / 2013

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	344	109	543
Suharekë	68	24	97
Dragash	15	5	20
Malishevë	74	10	84
<b>Total</b>	<b>501</b>	<b>148</b>	<b>649</b>

### 1.5 Zyra për planifikim dhe zhvillim - TM-4

Për periudhën që po raportojmë në kuadër të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në terren kanë vazhduar bllobimet nëpër qytetin e Prizrenit për të kryer refreshimin këto kanë arritur këto rezultate: Ujëmatës të bllobuar 410 Ujëmatës, Kontrata të nënshkruar 410 Kontrata, Konsumatorët që ekipa jonë nuk ka pasur qasje 397 konsumator , kjo mos qasje është përcjellë nga ekipi dhe herë pas herë janë vizituar deri sa kanë arritur të kenë qasje.

Konsumatorët që ekipi konstatoj që duhet të zëvendësohet ujëmatësi janë 6 Konsumator, Nuk ka pasur konsumator për shkak kushteve teknike që nuk janë bllobuar, Konsumator pa ujëmatës 2 Konsumatorët të pa regjistruar 10, Nuk ka pasur rekorde të reja për blockmapping , Nuk ka pasur instalim ujëmatësve, Bllobim për herë të dytë 31, Aktivizim i faturës 14.



	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	Bllombim-Kontrata	410
2	Dera Mbyllur( Herën e dyte)	397
3	Pa Regjistruar	10
4	Zëvendësime	6
5	Pa Ujëmatës	2
6	Rekorde të reja për blockmapping	0
7	Instalim	0
8	Bllombim për here te dyte	31
9	Aktivizim I faturës	14

#### Aktivitetet kryesore

\* Për këto muaj janë importuar 11 harta të reja në programin e GIS'it dhe janë ndërlidhur me faturim.

\* Janë bllobuar ujëmatësit e fshatrave Srbica e Ulet, Pusko, Shkoze dhe Dobrushte.

Të dhëna janë paraqit si më poshtë : Ujëmatëse të bllobuar 264, Nënshkrim I kontratave 264, Dera Mbyllur 130, Zëvendësim 9, Pa ujëmatës 28, Konsumatorët të peregjistruar 1, Problem teknik arritja tek ujëmatësi 3, Rekorde të reja për blockmapping 218, Lidhja ujit jo 86

\* Bllombim në fshatin Vermicë-Ujëmatës të bllobuar 75, Nënshkrim I kontratave 75, Dera Mbyllur 34, Zëvendësim të 3, Pa ujëmatës 3, Konsumator të pa regjistruar 1, Nuk ka pasur problem teknik, arritja tek ujëmatësi, Nuk ka pasur rekorde të reja për blockmapping, Nuk kanë lidhje të ujit 20\* Bllombim në fshatrat : *Nashec, Grazhdanik, Atmaxhë, Zhur, Shkozë, Vlashnje, Dobrusht, Kushnin*. Ujëmatës të bllobuar 28, Nënshkrim i kontratave 28, Dera Mbyllur 3, Bllombim për here të dyte 29, Nuk kanë pasur qasje të konsumatorit (pusetat e bllokuara) 5.

\* Në muajt Tetor, Nëntor, Dhjetor, grupet e terrenit të demontimit – montimit me njësi në Prizren kanë arritur që gjithsej të demontojnë dhe montojnë 456 ujëmatës.

\* Në muajt Tetor, Nëntor, Dhjetor grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellësit ka bërë gjithsej 137 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 86 defekte, ekziston raporti i veçantë.

Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 7248 m.

\* Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësve zonal për muajin Tetor, ku ujëmatësi të vendi i quajtur Ura e Gani Tades nuk punon edhe në këtë muaj, (që nga muaji Mars).

\* Në muajin Tetor është përfunduar projekti Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit në lagjen Arbana, Rrjeti primar, sekondar dhe kyçjet shtëpiake.

\* Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësve zonal për muajin Nëntor, ku ujëmatësit tek vendet e quajtura: Te KFOR-i, Jusuf Gërvalla, ETC, Atmaxh, Nashec I Eperm, Landovic, Gorozhup, Ura e Gani Tades dhe Kobaj për shkak të leximit i kemi inspektuar dhe kemi pa se tre prej ujëmatësve zonal janë në defekt : Atmaxh, Nashec i Eperm dhe Landovic, kemi marrë masa dhe shpresojmë që ditët në vijim ti riparojmë. Ujëmatësat tjerë janë në gjendje të rregullt raporton ekipi nga terreni.

\* Në muajin Nëntor është riparuar ujëmatësi zonal të vendi i quajtur Ura e Gani Tades me datë: 07.11.2013 nga CMC-ja (ky ujëmatës zonal nuk ka qenë në funksion që nga muaji Mars-Prill).

\* Në muajin Nëntor është raportuar nga grupi i Bazhdarimit se 9 konsumator kanë sjelle ujëmatësit për servisim dhe riparim në kompani

\* Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësve zonal për muajin Dhjetor, ku ujëmatësit zonal në pikat matëse: Atmaxhë, Landovicë janë pastruar dhe janë kthyer në funksion ndërsa ujëmatësi zonal në Nashec të Eperm është ndërruar me datë: 09.12.2013 për arsye se ka rezultuar defekt, pikat tjera janë kontrolluar dhe rezultoi se të gjithë ujëmatësit janë në gjendje të rregullt për muajin Dhjetor. Ekziston raport i veçantë i raportimit nga ekipi i bazhdarimit (servisim i ujëmatësve).

### 1.6 Shërbimi i mirëmbajtjes– servisimi i ujëmatësve: $\Phi$ (13 - 100) mm- TM / 4 - 2013

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipet e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit. Ky shërbim bënë servisimin dhe kalibrimin ujëmatësve të profileve  $\Phi$ (13-100)mm.

Njësia Operative	Profili Ø mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	112	
	3/4"	315	
	1"	30	
	5/4"	4	
	6/4"	0	
	Gjithsejtë:	<b>461</b>	
Suharekë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejtë:	<b>0</b>	
Dragash	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejtë:	<b>0</b>	
Malishevë	1/2"	0	
	3/4"	91	
	1"	0	
	Gjithsejtë:	<b>91</b>	
<b>Totali :</b>		<b>552</b>	

### Shërbimi i detektimit te rrjetit të ujës jellësit—TM-4

**Tetor**-Shërbimi i Detektimit gjatë muajit Tetor 2013, kanë këto aktivitete:

\*Pune efikase ditore në bazë të nevojave të kompanisë për operacione të Detektimit të ujit.

\*Analizimin dhe Kontrollimin e kërkesave te konsumatorëve te ujit.

\*Menaxhimin dhe raportimin për zhvillimin e aktivitete në të gjitha aktivitetet e lartshënuar.

Në kuadër të aktiviteteve të lartshënuara janë këto rezultate :\*Gjatësia e rrjetit të detektuar 1.513 m,\*Prurjet e gjetura gjatë detektimit 1.2 l/s,\*Kërkesa të shqyrtuara 54 raste ,\*Defekte të gjetura nga kërkesat e konsumatorëve 37,\*Defekte të gjetura ne rruge kryesore 4,\*Defekte të pa gjetura 13.

**Nëntor** -Shërbimi i Detektimit gjatë muajit Nëntor 2013, kanë këto aktivitete:

\*Pune efikase ditore në bazë të nevojave të kompanisë për operacione të Detektimit të ujit.

\*Analizimin dhe Kontrollimin e kërkesave te konsumatorëve te ujit.

\*Menaxhimin dhe raportimin për zhvillimin e aktivitete në të gjitha aktivitetet e lartshënuar.

Në kuadër të aktiviteteve të lartshënuara janë këto rezultate :

\*Gjatësia e rrjetit të detektuar – 3.215 m,\*Prurjet e gjetura gjatë detektimit – 1.2 l/s,\*Kërkesa të shqyrtuara – 41 raste ,\*Defekte të gjetura nga kërkesat e konsumatoreve – 22,\*Defekte të gjetura ne rruge kryesore – 3,\*Defekte të pa gjetura – 16

**Dhjetor-** Grupi i detektimi të rrjetit të ujësjellësit ka bërë gjithsej 42 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 27 defekte,ekziston raporti i veçantë. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 2,520m. \* Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësve zonal për këtë muaj,ku ujëmatësit zonal ne pikat matëse: Atmaxhë,Landovicë janë pastruar dhe janë kthyer ne funksion ndërsa ujëmatësi zonal ne Nashec te Eperm është ndërruar me date:09.12.2013 për arsye se ka rezultuar defekt,pikat tjera janë kontrolluar dhe rezulton se te gjithë ujëmatësit janë ne gjendje te rregullt për muajin Dhjetor.Ekziston raport i veçante i raportimit nga ekipi e bazhdarimit (servisim i ujëmatësve).

## 1.7 Raporti mbi cilësinë e ujit të pijes për TM-4

**Tetor** \*Janë marrë gjithsejtë 77 mostra në nivel regjional për analiza Bakteriologjike dhe të gjitha janë pozitive.

\*Janë marrë 39 mostra në nivel regjional për analiza Fiziko-Kimike dhe të gjitha u përgjigjen standardeve për ujin e pijes.

Mostrat nëpër njësi:

\*Prizren : Bakteriologjike- Gjithsejtë janë 54 mostra, ku të gjitha mostrat i përgjigjen, Fiziko-Kimike Gjithsejtë: janë29 mostra dhe i përgjigjen 29.

\*Therandë: Bakteriologjike- Gjithsejtë janë 15 mostra dhe 15 i përgjigjen standardit për ujë të pijes Fiziko-Kimike - Gjithsejtë 6 mostra dhe i përgjigjen 6.

\*Malishevë: Bakteriologjike- Gjithsejtë 4 mostra. i përgjigjen 4: Fiziko-Kimike—Gjithsejtë 2 mostra dhe i përgjigjen 2.

\*Dragash: Bakteriologjike—Gjithsejtë 4 mostra ku të gjitha mostrat I përgjigjen, Fiziko-Kimike--- Gjithsejtë 2 mostra ku të 2-ja mostrat I përgjigjen.

\*Lokacionet ku janë marrë mostrat për Prizren: Kroje publike : 22 mostra, Kroje në Restorane: 4 mostra, Kroje në shkolla : 6 mostra, Kroje në spital dhe ambulantë: 13 mostra,Kroje në furra: 1 mostër

Mostra janë marrë në xhamia e Rezervarët dhe burimet tona. .Në mënyrë të njëjtë është shtrirja e marrjes së mostrave edhe nëpër njësitë tjera.

**Nëntor** - \*Janë marrë gjithsejtë 111 mostra në nivel regjional për analiza Bakteriologjike dhe 110 prej tyre i përgjigjen, e 1 mostër nuk i përgjigjet .

\*Janë marrë 44 mostra në nivel regjional për analiza Fiziko-Kimike dhe të gjitha u përgjigjen standardeve për ujin e pijes.

Mostrat nëpër njësi:

\*Prizren: Bakteriologjike- Gjithsejtë janë 86 mostra, ku 85 mostra i përgjigjen standardeve të ujit të pijes e 1 mostër nuk i përgjigjet,Fiziko-Kimike Gjithsejtë janë 32 mostra dhe të 32-tat i përgjigjen.

\*Therand: Bakteriologjike- Gjithsejtë janë 15 mostra dhe 15 i përgjigjen standardit për ujë të pijes Fiziko-Kimike –Gjithsejtë 6 mostra dhe të 6-tat i përgjigje

\*Malishevë: Bakteriologjike- Gjithsejtë 5 mostra dhe të 5-tat i përgjigjen Fiziko-Kimike—Gjithsejtë 3 mostra dhe ato të 3-jat i përgjigjen

Dragash: Bakteriologjike—Gjithsejtë 5 mostra ku të gjitha mostrat I përgjigjen, Fiziko-Kimike---Gjithsejtë 3 mostra ku të 3-ja mostrat I përgjigjen

Lokacionet ku janë marrë mostrat për Prizren: Kroje publike : 22 mostra, Kroje në Restorane: 4 mostra, Kroje në shkolla : 6 mostra, Kroje në spital dhe ambulantë: 13 mostra, Kroje në furra: 1 mostër. Mostra janë marrë edhe në xhamia e Rezervuarët dhe burimet tona.

Në mënyrë të njëjtë është shtrirja e marrjes së mostrave edhe nëpër njësitë tjera.

**Dhjetor** -\*Janë marrë gjithsejtë 109 mostra në nivel regional për analiza Bakteriologjike dhe 101 prej tyre i përgjigjen, e 8 mostra nuk i përgjigjen .(kemi raportin e sektorit për analiza te ujit).

#### *Raporti i sektorit për kualitetin e ujit lidhur me tetë analizat ujit për muajin Dhjetor*

- *P.s. 8 mostrat të cilat nuk u përgjigjen standardeve të ujit të pijes janë mostra të cilat janë marrë në qytet të Prizrenit në ditët kur janë kryer punime si në „40-Burime “ po ashtu edhe në „Bunar-1”(mes bunarit 1 dhe ati 2 ) ku ka ardhur deri te penetrimi i ujit të turbullt në rezervuare kryesore dhe ku prej aty deri në rrjet , prezenca e klorit residual është e pranishme në të gjitha mostrat .*
- *Më 06.12.2013 mostra në ambulancën e fshatit Vlashnje, pastaj më 27.12.2013 mostra të harrura : K.P.,Tregu I Gjelbër “( prezenca e klorit residual është 0.3 mg/l sipas I.SH.P.) dhe në Rest.,Blerimi “afër stacionit të autobusëve( ku edhe aty prezenca e klorit ishte 0.2 mg/l) .Vazhdojmë me date 30.12.2013 mostra e marrë Rest.,Meli” , K.P.,Te Spitali “, Rest „Oreks “, Furra te „Kamberi “dhe kroi në I.SH.P.,Shërbimi I ekologjis humane “( ku prezenca e klorit residual është 0.1 mg/l në të gjitha mostrat e lartcekura ).*
- *Mostrat e lartcekura janë përsëritur me qëllim të përcjelljes së kualitetit të ujit të pijes përsëri nga I.SH.P..dhe atë me datë 03.01 ,09.01 ,10.01.2014 dhe në të tria rastet mostrat u përgjigjen standardeve të ujit të pijes .*

\*Janë marrë 41 mostra në nivel regional për analiza Fiziko-Kimike dhe të gjitha u përgjigjen standardeve për ujin e pijes.

Mostrat nëpër njësi:

\*Prizren : Bakteriologjike- Gjithsejtë janë 82 mostra, ku 74 mostra I përgjigjen standardeve të ujit të pijes e 8 mostra nuk i përgjigjen ,Fiziko-Kimike -gjithsejtë janë 31 mostra dhe të 31-tat i përgjigjen,

\*Therand: Bakteriologjike- gjithsejtë janë 15 mostra dhe 15 i përgjigjen standardit për ujë të pijes Fiziko-Kimike –Gjithsejtë 6 mostra dhe të 6-tat i përgjigjen

\*Malishevë: Bakteriologjike- gjithsejtë 3 mostra dhe të 3-iat i përgjigjen, Fiziko-Kimike -gjithsejtë 1 mostër dhe ajo i përgjigjet.

\* Dragash: Bakteriologjike-gjithsejtë 5 mostra ku të gjitha mostrat I përgjigjen, Fiziko-Kimike gjithsejtë 3 mostra ku të 3-ja mostrat I përgjigjen ,

\*Lokacionet ku janë marrë mostrat për Prizren:Kroje publike : 30 mostra,Kroje në Restorante: 18 mostra,Kroje në shkolla : 15 mostra,Kroje në spital dhe ambulantë: 10 mostra, Kroje në furra: 3 mostra, Mostra janë marrë edhe në xhamia e Rezervuarët dhe burimet tona. Në mënyrë të njëjtë është shtrirja e marrjes së mostrave edhe nëpër njësitë tjera.


\*P.s. 8 mostrat të cilat nuk u përgjigjen standardeve të ujit të pijes janë mostra të cilat janë marrë në qytet të Prizrenit në ditët kur janë kryer punime si në „40-Burime “ po ashtu edhe në „Bunar-1”(mes bunarit 1 dhe ati 2 ) ku ka ardhur deri te penetrimi i ujit të turbullt në rezervuare kryesore dhe ku prej aty deri në rrjet , prezenca e klorit residual është e pranishme në të gjitha mostrat .

**KORRIK-SHTATOR- 2013**

Muaji	Nr. Total	Biologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk l pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk l pergj.
KORRIK	114	114	109	5	0	45	1
GUSHT	101	101	97	4	0	44	0
SHTATOR	134	86	81	5	48	44	0
<b>Total</b>	<b>349</b>	<b>301</b>	<b>287</b>	<b>14</b>	<b>48</b>	<b>133</b>	<b>1</b>
% e Deshtimeve				4.7			2.1
% e Desht. Total							4.3

**TETOR-DHJETOR- 2013**

Muaji	Nr. Total	Biologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk l pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk l pergj.
TETOR	116	77	77	0	39	39	0
NENTOR	155	111	109	2	44	44	0
DHJETOR	146	105	97	8	41	41	0
<b>Total</b>	<b>417</b>	<b>293</b>	<b>283</b>	<b>10</b>	<b>124</b>	<b>124</b>	<b>0</b>
% e Deshtimeve				3.4			0.0
% e Desht. Total							2.4



### Aktivite e Njesisë punuese në Malishevë TM4- 2013

\*Hapja e pusetave dhe vendosja e ujëmatësve në Malishevë (lokale dhe amvisëri), Carrallukë, Shkozë dhe në Banje;

\*Janë hapur rreth 1000 puseta të financuara nga MPMS përmes memorandumit të bashkëpunimit ,si dhe janë montuar ujëmatësit në prona publike .

\*Gjatë periudhës së TM-4 është nënshkruar marrëveshje për menaxhimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve në mes: Hidroregjionit jugor, Kryetarit të Komunës së Malishevës, si dhe përfaqësuesi i fsh. Shkozë pas nënshkrimit të marrëveshjes ekipet tona kanë bërë verifikimin dhe regjistrimin e 74 konsumatorëve, kanë bërë montimin e ujëmatësve.

**Qëllimi** –Zvogëlimi i humbjeve të ujit,eliminimi i kyçjeve ilegale ,leximi më i lehtë i ujëmatësve.

\***Fillimi i punimeve në** Projektin e vendosjes së gypit DN-90mm nga Rr.”H.Berisha” Malishevë deri ne lagjen Pallanka L=3500 m.

Punimet kanë përfunduar si hapja e kanalit ,shtrirja dhe vendosja e gypave dhe montimi i të gjitha pjesëve përcjellëse –montuese. Vlera e këtij projekti është =**14.000 €**

**Qëllimi** :Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit edhe në një lagje të Malishevës ku përfitojnë mbi 30 familje me rreth 300 banor. .Tani si pjesë e këtij projekti kanë mbetur të pa realizuara vetëm kyçjet individuale dhe montimi i ujëmatësve.

\***Fillimi i punimeve në Projektin e Depos tek zyret e HRJ-së në Malishevë.** Deri në fund të muajit dhjetor/14 janë kryer rreth 60% të punimeve në këtë projekt i cili projekt kap shumën mbi 10.000 €.

**Qëllimi:**Me këtë projekt do të zgjidhet problemi i depos për pjesë rezerve ,mjete të punës si dhe garazhet për të gjitha automjetet e Njesisë punuese në Malishevë.

Vendosja e rrjetit të ujësjellësit në Rr.”Gjergj Kastrioti “ Malishevë L=600m gypi fi 63 mm.

Kostoja =5.690.00 €

**Qëllimi** : Për shkak të zgjerimit të kësaj rruge nga KK ,jemi detyruar që për shkak të qasjes më lehtë të konsumatorëve në këtë gyp si dhe me qëllim të ikjes së intervenimeve në gypin kryesor  $\Phi$  315 mm.

### Aktivite e Njesisë Suharekë –TM 4- 2013

Në fshatin Studenqan si pasojë e mungesës së ujit në burim që si pasojë e kësaj mungese pompa ka pas ndërprerje të shpeshta dhe për këtë arsye herë pas here janë aplikuar reduktime të ujit për pjesën e fundit të fshatit.

Ndërsa në fshatin Sallagrazhdë si pasojë e energjisë elektrike e cila ka qen tension shumë të dobët dhe për këtë nuk kanë punuar pompat fare,me ngritjen e temperaturës është përmirësuar pak mirëpo pasi që nuk ka qen tensioni stabil e ka djegur njëren pompë 9.2kw, ndërsa për momentin është duke funksionuar vetëm njëra pompë 5.5kw dhe një sasi e vogël,me gravitet.

\*Pastrimi i objekteve-Në këtë muaj janë pastruar rrethojat e objekteve përcjellëse në :Studenqan, Semetishtë dhe objekti në stacionin e pompave në Topallnica në Suharekë.

Gjithashtu është pastruar dhe dezinfektuar rezervari në fshatin Semetishtë

\*Pastrimi i pusetave të kanalizimit në rrjetin e kanalizimit në qyteti - Janë pastruar 22 puseta të kanalizimeve dhe janë zëvendësuar 3 kapakë të pusetave të cilat kanë qen të dëmtuar. Pastrimi i pusetave të kanalizimit do jetë i vazhdueshëm për secilin vendbanim.



\*Pastrimi dhe rregullimi i pusteve të ujësjellësit për hyrjet e banesave të „Ballakanit” dhe hyrjet e banesave të Podrumit- Janë pastruar dhe janë zëvendësua valvulet për të 4 hyrjet e banesave të ballkanit dhe dy hyrjeve në banesat e Podrumit në mënyrë që për çdo problem uji të ndalet vetëm në atë hyrje ku ka problem e jo komplet lagja.

Për të gjitha pusetat janë zëvendësuar pjesët e vjetra me të reja duke përfshirë edhe valvulet me dhe kapakët e pusetave.

\*Realizimi daljes nga gypi DN-315mm PE nga Savrova-rez-Shirokë me gyp DN-63mmPE- Në hyrje të Sopis nga Suhareka me kërkesën e një grupi të konsumatoreve për kyçje në këtë gyp të ujësjellësit është realizuar një dalje nga gypi kryesor DN-315mm/DN-63mm

Kjo dalje do të vlejë për të gjithë ata konsumatorë të cilët gjinden për rreth kësaj dalje e cila do të jetë e kontrolluar .

\*Vazhdimi i punimeve në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Semetishtë- Janë rregulluar të gjitha defektet në rrjetin ekzistues dhe është zëvendësuar një pjesë e rrjetit me gjatësi L=450m me gyp DN-90mmPE ende nuk është bërë regjistrimi i konsumatorëve mirëpo në ato pjesë ku janë zëvendësuar gypat janë kyçur në rrjet rreth 12 konsumator te ri

Për shkak se në kanal in ku ka qen gyp i ekzistues I ujësjellësit ka basë edhe shumë gypa privatë janë bërë edhe shumë defekte pasi që ka qen e pa mundur të punohet pa I dëmtuar këta gypa të cilët pas përfundimit të punës janë riparuar kjo ka qen edhe njëra nga arsyet që punimet kanë zgjatur shumë.

\*Përgatitja e vendit për realizimin e lidhjes së gypit DN-315mmPE nga rezervarët kryesor "Krisma" me gypin ekzistues DN-450mmPE te Pusit Atit në Gelanc- Është përgatit vendi ku do të bëhet kjo lidhje është gjetur gyp i DN-450mmPE dhe është hapur gropa për ta shpuar asfaltin. Punët e montimit e kësaj nyje nuk janë realizuar pasi që temperaturat kanë qen -5grad.

### **Raport për ndërtimi i Rezervuarëve të ujit “Krismat e Sali Shabanit” në Baqevc - Suharekë**

#### **Disa detaje teknike dhe arsyeshmëria e investimeve në këtë projekt**

Projekti Rezervuari i ujit me vëllim  $V=3000 \text{ m}^3$  „Krismat e Sali Shabanit“ në Baqevc, është financuar nga MZHE, me vlerë prej 500 mijë euro. Në kuadër të këtij financimi përfshihet edhe shtrirja e linjës së tubacioneve me diametër DN 315 mm PE prej Rezervuarit deri në magjistralen Prizren-Suharekë më saktësisht në rrugën e fshatit Gelancë, në gjatësi prej 5000 m, ku përfshihet hapja e kanalit me thellësi 150 cm, shtrirja e tubacioneve, hapja e pesë pusetave përgjatë linjës, furnizimi dhe montimi i një valvule për ndalje dhe një për zbrazje në secilën nga këto puseta si dhe vendosja e pusetave prej betoni për mbrojtjen e këtyre valvulave. Po ashtu në pikë takimin e kësaj linje me linjën ekzistuese të tubacioneve në vijën Pusi atit – Suharekë me diametër të tubit DN 450 mm PE, është hapur puseta, është bërë depërtimi me shpim i tokës nën rrugë, është bërë furnizimi dhe lidhja e gypave me pajisje të diametrit përkatës, si dhe është ndërtuar puseta prej hekuri dhe betoni për mbrojtjen e pajisjeve të kësaj lidhje.

Krahas këtij projekti, në afërsi të Rezervuarit është bërë hapja e tetë puseve me thellësi të ndryshme, të cilat pasi janë matur dhe testuar, është konstatuar se sigurojnë një sasi të ujit prej 70 l/s. Kjo do të thotë se Rezervuari me vëllim prej  $3000 \text{ m}^3$ , mbushet me ujë përafërsisht për 14 orë dhe furnizon me ujë për 24 orë rreth 15.000 banorë, duke i llogaritur nga 200 l ujë për një banor.

Përpos kësaj sasi të ujit, në një distancë prej rreth 1200 m më lartë nga Rezervuari, është gërmuar një sasi e madhe dheu si dhe janë shpuar edhe pesë puse tjera. Këtu është paraparë të gërmohet (thellohet) edhe për 7-8 metra dhe varësisht nga pjerrtësia e terrenit në disa metra gjatësi, ashtu që të ndërtohet një lloj galerie ku do të grumbullohet një sasi e konsiderueshme uji (sipas parashikimeve 30-40 l/s) me rënie të lirë, si dhe uji që do të futet në galeri me pompa nga pusët në afërsi rreth 40 l/s. Kjo sasi uji do të arrijë në Rezervuar me rënie të lirë dhe praktikisht sasia e tërësishme e ujit në këtë projekt llogaritet të jetë rreth 150 l/s.

Duhet theksuar se shpimi i këtyre puseve është financuar nga Komuna e Suharekës në vlerën prej 150 mijë euro, sipas një marrëveshje të nënshkruar në mes të zyrtarëve komunal dhe atyre të K.R.U „Hidroregjioni jugor“ në Prizren, ndërsa gërmimet e gjertanishme janë kryer me vet financim të Kompanisë.

### Arsyeshmëria ekonomike e projektit

1. Me realizimin e tërësishëm të këtij projekti, planifikohet të furnizohen me ujë të pijes edhe disa fshatra të Komunës së Suharekës që deri më tani nuk kanë pasur furnizim, si Greikoci, Gelanca, Leshani, Tërnja, Dubrava, Baçevci, si dhe Gjinoci e Sallagrazhda (përmirësim i furnizimit).
2. Për shkak të afërsisë së madhe të pompave me Rezervuarin, zvogëlohet në masë të madhe munda i pompave sepse punojnë vetëm në nxjerrje të ujit dhe jo edhe në shtyrje në distancë të gjatë siç është rasti te Pusi i atit, ku pompohet uji në gjatësi 10 km dhe kjo na mundëson të përfitojmë në masë të madhe në jetëgjatësinë dhe rendimentin e pompave.
3. Një sasi e konsiderueshme e ujit në Rezervuar arrijë me rënie të lirë.
4. Rezervuari gjendet në lartësinë mbidetare që i mbulon me rënie të lirë, të gjitha vendbanimet e lartë cekura si dhe disa pjesë të qytetit të Suharekës që deri më tani nuk kanë mundur të furnizohen me sistemin ekzistues.
5. Dukshëm reduktohen shpenzimet e rrymës elektrike që deri më tani po ndikojnë negativisht në performancën financiare të Njësisë tonë.
6. Zgjerohet zona e vendbanimeve nën menaxhimin e Kompanisë, që sigurisht do të ndikojë edhe në rritjen e inkasimit dhe përmirësimin të performancës.

### Investime tjera

Në këtë tremujor kemi zgjeruar dhe përmirësuar (ndërruar) rrjetin e ujësjellësit në gjatësi prej rreth 500 m në fshatin Semetisht, që praktikisht është përmirësuar edhe furnizimi me ujë i qytetarëve si dhe pritet të regjistrohen një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve të rinj si pasojë e zgjerimit të rrjetit.

Për shkak të thatësisë dhe mungesës së të reshurave për një kohë të gjatë, kemi pasur mungesë të ujit në fshatin Studenqan, prandaj jemi detyruar që të bëjmë një lidhje fizike të rrjeteve të ujësjellësit të këtij fshati me atë të fshatit Reshtan në një linjë me gjatësi prej 250 m, ashtu që sadopak të përmirësohet furnizimi, gjë që ka ndikuar pozitivisht.

Angazhimi i vazhdueshëm i të gjitha resurseve materiale dhe njerëzore të Njësisë tonë, në realizimin e këtyre projekteve, domosdoshmërisht që ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve si të atyre investime, po ashtu edhe atyre operative duke përfshirë orët shtesë të punës së punëtorëve, derivatet, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve dhe mjeteve të punës, etj.

## Aktivitetet mujor - Njësia Dragash

Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhur gjatë këtij muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftushëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radeshë.

Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimësi.

Aktivitetet e ekipit teknik operativ gjatë këtij muaji kanë qenë:

9 raste në sanimin e rrjetit të ujësjellësit, 2 ndërrime të ujëmatësve, 3 montime të ujëmatësve, (1 copë 1" dhe 2 copë ¾"), 37 pastrime dhe kontrollime të ujëmatësve, 2 puseta të pastruara të kanalizimit, 60m pastrime dhe deblokime në rrjetin e kanalizimit, 1 shkyqje në rrjetin e ujësjellësit, 12 intervenime të tjera të ekipit teknik. Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon Kompania duke përfshirë këtu punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratë së përgjithëshme.

Gjatë këtij muaji jemi angazhuar edhe në verifikimin e funksionimit të ujsjellsit të fshatit Brezne si dhe janë mbajtur takime me përfaqësuesin e këtij fshati për marrjen në menagjim të këtij ujsjellsit i cili është vënë në funksion në muajin dhjetor pas investimeve të bëra nga donatorët dhe Kuvendi Komunal në Dragash.

## II. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË

### 2.1 Aktivitetet

- Në fund të këtij tremujori në nivel rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 38.838 fatura, prej tyre: 33.637 amvisëri, 4.625 biznese dhe 616 institucione. Në fund të këtij tremujori në krahasim me fundin e tremujorit paraprak kemi 387 fatura të lëshuara me tepër. Nga ky numër 133 konsumatorë janë rezultat i pëlqimeve për kyçje të re ndërsa 254 konsumatorë janë rezultat i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës dhe rezultat i pëlqimeve për kyçje në shërbim të ujësjellësit dhe kanalizimit. Sipas njësive kemi këtë rritje të konsumatorëve në krahasim me TM4 në krahasim me TM3 : Prizren: + 196, Suharekë: +132, Malishevë: + 46, Dragash: +13
- Gjatë muajit TM4 janë faturuar 1,775,833 m<sup>3</sup> ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1.422.244 m<sup>3</sup>, biznese: 128.629 m<sup>3</sup> dhe institucione 224.690 m<sup>3</sup> ujë. Nëse e krahasojmë me tremujorin paraprak kemi një ne faturim më të vogël prej 451.057 m<sup>3</sup>.
- Arsyetim:
  - Rënie e faturimit për TM4 është rezultat i rënies së konsumit në këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake .
  - Punimet në riparimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit, si rezultat i kësaj lagje dhe rrugë të caktuara kanë mbet pa furnizim me ujë për kohë të caktuar.
  - Mungesa e furnizimit me ujë për tre muaj e fshatit Luginë si pasojë e turbullimit të ujit në burimin ekzistues. (muaji shtator, tetor dhe nëntor 2013). Ky fshat ka 259 konsumator dhe faturimi mujor i këtij fshati sillet diku rreth 4400 m<sup>3</sup>- 4500 (për tre

muaj kemi mungesë në faturim 13.200 m<sup>3</sup> deri 13.500 m<sup>3</sup>). Këtu vlen të ceket edhe mos faturimi i Mamushës ( rreth 520 konsumatorë) dhe Landovicës (rreth 140 konsumatorë, ku 90 prej tyre janë aktiv), të cilët nuk faturohen gjatë gjithë vitit 2013.

- Një ndër arsytet është po ashtu edhe ndërprerja e furnizimit me ujë të pijes në fshatin Sallagrazhde dhe Studenqanë si pasoje e djegies së pompës.
- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe shkyçjes në kuadër të KRU „Hidroregjioni Jugor“ sh.a., në bashkëpunim me udhëheqësit e njësisive.

#### RAPORT I EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES – TM3- 2013

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
1	Prizren	339	19	18	2645	<b>47,414.72 €</b>
2	Suharekë	285	43	29	604	<b>11,420.00 €</b>
3	Malishevë	57	17	28	551	<b>6,643.30 €</b>
4	Dragash	5	1	1	51	<b>0.00 €</b>
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	<b>686</b>	<b>80</b>	<b>76</b>	<b>3851</b>	<b>65,478.02</b>

#### RAPORT I EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES – TM4- 2013

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
1	Prizren	339	6	5	2209	36,096.00 €
2	Suharekë	117	25	28	1589	14,522.84 €
3	Malishevë	18	7	11	633	5,513.36 €
4	Dragash	5	1	0	50	0.00 €
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	<b>479</b>	<b>39</b>	<b>44</b>	<b>4481</b>	<b>56,132.20 €</b>

- Në nivel rajonal kemi pranuar 480 ankesa të konsumatorëve prej tyre:
  1. 352 ankesa teknike- detektive, mungesë të ujit, rrjedhje të ujit
  2. 128 ankesa komerciale- ankesa rreth faturimit paushall të rritur, kontestim i faturave, faturim i dyfishtë etj

Të gjitha ankesat dhe kërkesat janë realizuar nga shërbimet dhe departamentet përkatëse në kohë dhe nivel të kënaqshëm.

- Vazhdim i aksionit për njoftime për shkyçje të konsumatorët që:

- Nuk i janë përgjigjur pagesave në dy muajt e fundit sidomos konsumatorët institucional dhe ka fillu ri programimi i borxhit.
- Kanë borxhe mbi 400 euro dhe nuk i përgjigjen pagesës dhe ri programimit të borxhit. Janë ndërrua terrenet e inkasantëve në mënyrë që të përfshihen numër më i madh i konsumatorëve.
- Kontrollë te konsumatorët rreth eliminimit te keqpërdorimeve te ujit
- Pjesëmarrje në takimet mujore në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ku pjesëmarrës në këto takime janë zyrtar nga ZRRUK dhe përfaqësues nga Kuvendet Komunale të zonës së operimit të KRU „Hidroregjioni Jugor“sh.a.
- Vizita në njësit operative me udhëheqësit e njësive lidhur me rritjen e efikasitetit rreth rritjes së faturimit, inkasimit dhe kontrollës te konsumatorët.

## 2.2 Pengesat në realizimin e objektivave:

- Rasti i sulmit të punëtorin te shërbimit të kontrollës gjatë kryerjes së punëve të përditshme në inkasim të borxheve te vjetra dhe shkyçje, ka ndikuar negativisht tek konsumatorët në pagesë të obligimeve të tyre dhe njëkohësisht ka zbeh për një kohë të shkurtër punën në shërbimin e kontrollës.
- Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellësit :
  1. Te konsumatorët e amvisërisë- gjendja e rënde ekonomike , e cila po rritet nga dita në ditë. Kjo mbështetet në faktin në paraqitjet në zyret e shërbimit me konsumatorë të rasteve të kësaj kategorie të konsumatorëve
  2. Te bizneset – pamundësia e pagesave rrjedhëse e cila vjen nga rënia e punës në biznese, nga fuqia financiare e cila po bie çdo ditë.
  3. Te konsumatorët insticional –planifikimet e vogla në buxhet te organizatat buxhetore si dhe alokimet buxhetore në periudha tremujore po e pamundësojnë pagesën rrjedhëse për çdo muaj te kjo kategori.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për ti paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mos furnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktime) po ndikojnë në inkasim të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

## 2.3 Planet në vazhdimësi

- Takime me përfaqësuesit e lagjes „Kurila“ dhe përfaqësues nga Policia e Kosoves dhe Inspektorati Komunal dhe për mundësinë e gjetjes së formave dhe mundësive për fillimin e nënshkrimit të kontratave për ri programim të borxheve.

- Formimi i dy ekipeve për së bashku me operativen për shkyçjen e konsumatoreve borxhlinj të madhej mbi =400,00 E në muaj do të shkyçen 10-20 konsumator të cilët nuk i përgjigjen pagesës, ky aktivitet do të zhvillohet me ekskavator i cili do të aktivizohet 3 ditë brenda javës.
- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shuma të larta të burgjeve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për ri programimin e burgjeve në mënyrë që këta konsumatorë të futen në sistem të pagesave të faturave nëpërmes inkasantëve të tereni, ekipeve të kontrollës në teren.
- Do të ju mundësohet konsumatorëve nënshkrimin e kontratës për ri programim të borxhit edhe me pagesa më të vogla se 30% .
- Marrja e masave ligjore duke respektuar procedurat e ZRRUK për shkyçjen e konsumatoreve për mos pagesë, këto raste do të procedohen të Shërbimi Juridik.
- Rritja e efikasitet të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyçjes, duke e rritur numrin e konsumatorëve që duhet të vizitohen brenda muajit.
- Inicimi i padisë te konsumatorëve në gjykatë për mos pagesë të borxheve nëpërmes shërbimit juridik
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e burgjeve aty ku kanë vështirësi inkasantët.
- Angazhim i ekipes së kontrollës nga Prizreni në njësit tjera , varësisht nga kërkesat e udhëheqësve të njërive.

## 2.4 RAPORTI PËR MEDIA

Një nga qëllimet kryesore të KRU-“Hidroregjioni Jugor”, (përveç furnizimit me ujë dhe inkasimit, mirëmbajtjes së rrjetit, etj.) është edhe që ta informojë opinionin publik, gjegjësisht konsumatorin për të gjitha ngjarjet që ndodhin në Kompani apo për problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet kompania, gjithashtu ta informojë konsumatorin me kohë shpejtë dhe saktë për pengesat, ndërprerjet në furnizim apo defekte të ndryshme.

Për t'u realizuar këto qëllime sa më mirë, funksionon zyra për informim dhe zëdhënësi.

Detyrat kryesore të këtyre dy mekanizmave janë që të mblidhen të gjitha informatat në kuadër të kompanisë, gjegjësisht shërbimet përkatëse dhe ato të përpunohen dhe të plasohen në opinionin publik, në mënyrën më të përshtatshme dhe të kuptueshme për opinionin.

Pra, të gjitha informatat që vijnë nga shërbimet e ndryshme e që janë me interes për konsumatorin, përpunohen dhe përcillen në të gjitha mjetet e informimit.

Në këtë drejtim kemi marrëveshje dhe bashkëpunim të mirë me të gjitha televizionet dhe radiot lokale, gjithashtu nuk mungojnë edhe kontaktet me televizionet qendrore, po ashtu edhe me shtypin ditor.



Zyra për marrëdhënie me publikun, është munduar që nga fillimi i vitit 2013, që përcjelljen e porosisë që del nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a., përmes medieve elektronike dhe të shkruara, ta bartë te opinioni publik, në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më të ndershme, njëkohësisht duke mbrojtur interesat e kompanisë në përgjithësi dhe konsumatorit në veçanti.

Mediet lokale, i kanë kushtuar hapësirë të mjaftueshme KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. Kanë dhënë kontribut të madh në mënyrë indirekte dhe direkt në ngritjen e shkallës së arkëtimit, në vetëdijesimin e qytetarëve, se uji që shpenzohet duhet kursyer dhe duhet paguar, në informimin e qytetarëve se ujësjellësi i Prizrenit është duke punuar në atë drejtim që t'i përmirësojë shërbimet e veta ndaj çdo konsumatori, se kjo kompani me përkushtimin e saj më të madh, ka arritur që të përfitojë donacione të mëdha nga investitorët e huaj dhe Qeveria e Kosovës, vetëm e vetëm që konsumatorëve të saj t'u ofrojë shërbime sa më cilësore.

Edhe mediet e shkruara kanë dhënë kontribut të mjaftueshëm në shpërndarjen e informacioneve të opinionit publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. dhe se hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.



## RAPORT PËR MEDIA

MUAJI: JANAR – DHJETOR 2013

Nr.	PËRSHKRIMI	MEDIAT	NUMRI TOTAL
1	<b><u>NJOFTIME</u></b> TV RADIO SHTYPI DITOR	TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO HELIX RADIO THERANDA LAJM	32
2	<b><u>INTERVISTA</u></b> TV RADIO	RTK KLAN KOSOVA TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO KOSOVA RADIO AVAZO	17
3	<b><u>EMISIONE</u></b> TV RADIO	RTK KLAN KOSOVA TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO KOSOVA	7
4	<b><u>REPORTAZH - TV</u></b>	<a href="http://www.kosovapress.com">www.kosovapress.com</a>	1
5	<b><u>KONKURSET</u></b>	LAJM	29
6	<b><u>ARTIKUJT-SHTYPI DITOR</u></b>	KOHA DITORE KOSOVA SOT ZËRI LAJM EPOKA E RE GAZETA TRIBUNA	39
7	<b><u>ARTIKUJT- SHTYPI ELEKTRONIK</u></b>	<a href="http://www.tv-opinion.com">www.tv-opinion.com</a> <a href="http://www.kosovasot.info">www.kosovasot.info</a> <a href="http://www.prizrenpres.com">www.prizrenpres.com</a> <a href="http://www.rtklive.com">www.rtklive.com</a> <a href="http://www.kosovapress.com">www.kosovapress.com</a> <a href="http://www.telegrafi.com">www.telegrafi.com</a> <a href="http://www.gazetatribuna.com">www.gazetatribuna.com</a> <a href="http://www.koha.net">www.koha.net</a> <a href="http://www.epokaere.com">www.epokaere.com</a> <a href="http://www.kosovain.eu">www.kosovain.eu</a> <a href="http://www.gazetaexpress.com">www.gazetaexpress.com</a>	34
8	<b><u>KONFERENCË PËR MEDIA</u></b>	RTK KLAN KOSOVA TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI	3
9	<b><u>DEBAT PËR UJËRA TË ZEZA</u></b>	TV-BESA <a href="http://www.tv-opinino.com">www.tv-opinino.com</a>	1

## KONKLuzion

KRU-“Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren, gjatë vitit 2013, ka dërguar 30 njoftime, në mediat elektronike dhe të shkruara, lidhur me aktivitetet që po ndërmerren nga kompani, filluar nga furnizimi me ujë të pijshëm, aplikimi i shkyçjeve, qoftë kolektive apo individuale, e deri te cilësia e ujit që konsumatorët e marrin në krojet e tyre.

Disa nga njoftimet janë emetuar në televizione, e disa janë publikuar si shkrime në shtypin ditor, duke dhënë çdo herë një mesazh për opinionin publik.

Mediat janë për t'u lavdëruar në shpërndarjen e informacioneve të opinionit publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarrë nga KRU-Hidroregjioni Jugor dhe hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

Mbulueshmëria mediale për KRU- “Hidroregjioni Jugor”, për vitin 2013 ka qenë e kënaqshme dhe e mjaftueshme.

Raporti Gazetar- Zëdhënës ka qenë i lakmueshëm.

Mediat elektronike dhe të shkruara kanë kontribuar edhe në ngritjen e shkallës së arkëtimit në KRU-Hidroregjioni Jugor, duke plasuar informacione të shumta në publik, lidhur me aktivitetin e shkyçjeve të konsumatorëve borxhlinjë.

Të gjithë artikujt e gazetave ditore dhe të gjitha intervistat, emisionet e drejtpërdrejta në televizione dhe radio, janë të ruajtura në arkivën e zyrës për marrëdhënie me publikun.

### **III. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV**

#### **3.1 Aktivitetet**

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marrë me përgatitjen e raporteve ditore, javore dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Pas përgatitjes së Procesverbaleve të Bordit, Komisionit të Auditimit dhe të komiteteve janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me konkluzionet apo raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.
- Janë vazhduar kontratat e punës për të gjithë punëtorët e Kompanisë, kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Janë përgatitur dhe shpallur në shtypin ditorë 2 (dy) konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë. Pas mbylljes së konkursit përkatës më vendim është caktuar komisioni i cili shqyrton aplikacionet e aplikantëve, përgatit listën e ngushtë të kandidatëve, kryen testin me shkrim dhe intervistën si dhe bënë zgjedhjen e kandidatit.
- Është bërë ndryshimi i koficientit të disa punonjësve pas kërkesës me shkrim nga udhëheqësit e tyre dhe aprovimit nga Zyrtari Kryesor financiar dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendeve të punës me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.

- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimin apo pëlqimin nga udhëheqësit e tyre.
- Për shkelje të lehtë të detyrave të punës është shqiptuar 1 (një) Vërejtje me shkrim për punonjësen e njësisë së Suharekës.
- Është bërë largim i përkohshëm nga puna te një punëtori të njësisë së Dragashit për shkak se ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale dhe se i punësuar në fjalë është në vuajtje të paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji.
- Në Kompani janë duke bërë punë praktike profesionale student të Universitetit të Prizrenit në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është duke u zhvilluar në mbikëqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
- Janë përgatitur Vendimeve për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik te punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave te njësive punuese.
- Përgatitja e Aktvendimeve për pushim pa pagesë për disa punëtor të Kompanisë pas aprovimit të kërkesës së tyre nga udhëheqësi i shërbimit përkatës.
- Përgatitja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompensimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
- Në bazë të nenit 2.paragrafi 1. të Ligjit Nr. 2003/19 për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës dhe të nenit 5.paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë është bërë pagesa e shpenzimeve të mjekimit nga lëndimi në punë për disa punëtor.
- Nga Kryeshefi Ekzekutiv është formuar Komision i veçantë për analizimin e formimit të Shërbimit të Inspektoratit në nivel Regjional. Puna e Komisionit është paraqitur në Komitet për Staf dhe shpërblime e që ka mbetur të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komitetit për staf.
- Është përgatitur urdhëresë për ndërmarrjen e hapave për preventivë dhe siguri të objekteve e njësive operuese dhe i është drejtuar udhëheqësve të njësive punuese pranë KRU”Hidroregjini Jugor”Prizren.
- Nga MMPH kemi pranuar VENDIME ku aprovohet kërkesa e KRU”Hidroregjionit Jugor”e datës 30.08.2012 dhe vazhdohet afati I lejes ujore për shfrytëzimin e ujit nga burimi në Prizren, Lumi Radesga-Dragash,rezervuari Shirok në Suharekë dhe shpimi në Banjë në Malishevë. Vazhdimi I lejes ujore është në afat prej 5 viteve nga data e aprovimit të Vendimit. Leja ujore vazhdohet nën kushtet vijuese me të cilat kushte është njoftuar Kryeshefi Ekzekutiv dhe menaxhmenti në takimin e datës 18.11.2013.
- Në Departament të Administratës është bërë auditim nga Auditori I Brendshëm,temë e auditimit ishte Menaxhimi i procesit të vlerësimit të punëtorëve në Hidroregjionin Jugor për vitin 2013. rekomandimet e dhëna në draft raportin e Auditorit janë pranuar dhe kanë filluar menjëherë të implementohen.
- Dokumentet e kërkuara nga Zyra e Auditorit të përgjithshëm janë skanuar dhe dërguar me kohë.
- Pjesëmarrje në Konferencën dhe ekspozitën e përbashkët Vjetore të organizuara nga SHUKOS dhe SHUKALB me temë “Viti i Bashkëpunimit për ujin”.

### 3.2 PERSONELI – TETOR– DHJETOR 2013

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Verejtje
tetor	291	2	2	0	3 punt.push.pa pages
nëntor	291	0	0	0	2 punt.pushim pa pages 1 punt.pushim të lehonisë
dhjetor	291	1	1	0	

### NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR 2013

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	237	36	6	12	291
Numri i Punëtorëve në %	81.4	12.4	2.1	4.1	<b>100</b>

### NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	32	11.00	
MESHKUJ:	259	89.00	
TOTAL	291		

### KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2013

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A						
Kualifikimi	KUALIFIKIMI					
	Fakultet	Bachelor	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	<b>27</b>	<b>17</b>	<b>187</b>	<b>55</b>	<b>5</b>	<b>291</b>
Kualifikimi në %	<b>9.28</b>	<b>5.84</b>	<b>65.29</b>	<b>17.87</b>	<b>1.72</b>	

### 3.3 Raport rreth Punës së Zyrës Ligjore

#### Raporti i tremujorit të katër Gjykata Themelore në Prizren Tetor – Dhjetor 2013

Periudha raportuese	Padi	Përgjigje në padi	Seancat përgatitore	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruara nga Kompania	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruara nga Konsumatorët	Përgjigje në Ankesat e Parasht-ruara në Gjykatën e Apelit nga Konsumatorët	Vendimet e revizionit	TOTALI	Totali i lëndëve të ardhura nga Gjykatat
Tetor	1	/	3	1	2	/	1	2	1	11	15
Nëntor	/	1	/	3	4	1	1	1	/	11	13
Dhjetor	/	/	/	3	2	2	/	/	/	5	6
Totali	1	1	3	7	8	3	2	3	1	29	34

#### PADI TË USHTRUARA KUNDËR KOMPANISË

Me datë **25.10.2013**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Padi, C.nr. 611/13**, datë 23.10.2013, ku Padiçesi "**Malik Impex**", NSHT me seli në Rr. Ortakoll, nr. 33 në Prizren, me Kërkesë për **rimbursim të dëmit** në vlerë prej **3013 €**.

#### PËRGJIGJE NË PADI

Me datë **08.11.2013**, është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren **Përgjigje në Padi, C.nr. 611/13**, datë 23.10.2013, kundër Padiçesit "**Malik Impex**", NSHT me seli në Rr. Ortakoll, nr. 33, në Prizren, lidhur me Kërkesën e Padiçesit për **rimbursim të dëmit** në vlerë prej **3013 €**.

#### ANKESA NË GJYKATËN E APELIT NGA Kompania

Me datë 15.11.2013, Në Gjykatën Themelore në Prizren është parashtruar **Ankesë** për në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër **Aktgjykimit lidhur me lëndën C.nr. 189/06**, datë **18.10.2013**, me të cilin refuzohet si e pabazuar Kërkesëpadija e Padiçesit K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A. në Prizren, ndaj Debitorit Imer Bislimaj, për pagesë të borxhit ndaj Kompanisë.

Me datë 27.12.2013, në Gjykatën Themelore në Prizren është parashtruar **Ankesë** për në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër **Aktgjykimit lidhur me lëndën C.nr. 424/06**, datë **03.12.2013**, të Debitorit Eshref Krasniqi, me të cilin Ankimohet ky Aktgjykim dhe kërkohet që çështja të shkojë në rigjykim dhe rivendosje ku do të detyrohet Debitori për pagesë të borxhit ndaj Kompanisë sonë.

Me datë 30.12.2013, në Gjykatën Themelore në Prizren është parashtruar **Ankesë** për në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër **Aktgjykimit lidhur me lëndën C.nr. 336/06**, datë **21.11.2013**, të Debitorit Avni Jakupi, me të cilin Ankimohet ky Aktgjykim dhe kërkohet që çështja të shkojë në rigjykim dhe rivendosje ku do të detyrohet Debitori për pagesë të borxhit ndaj Kompanisë sonë.

#### ANKESA NË GJYKATËN E APELIT KUNDËR KRU-së

Me datë **10.10.2013**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Ankesë lidhur me lëndën C.nr. 745/05**, nga Padiçesi **Vahid Kabashi**, i cili e konteston Aktgjykimin e marrë nga Gjykata



Themelore në Prizren lidhur me Kërkesëpadinë e tij për kompensimin e kinse dëmeve të shkaktuara nga gypat e ujësjellësit të Kompanisë sonë.

Me datë **08.11.2013**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Ankesë lidhur me lëndën C.nr. 1515/13**, nga Ankimuesi **Njazi Ademaj**, i cili i drejtohet **Gjykatës së Apelit në Prishtinë** nga që e konteston Aktvendimin e marrë nga Gjykata Themelore në Prizren pasi që sipas Paditësit, me Propozimin plotësues është kërkuar që Gjykata ta kthej në punë dhe detyra të punës drejtor, ashtu siç ka qenë para largimit nga puna si dhe kundërshtohet se kjo çështje është çështje e gjykuar (Res Judicata).

### PËRGJIGJE NË ANKESA

Me datë **03.10.2013**, është bërë Përgjigje në Ankesë ndaj Paditësit **Ilijaz Buleci**, lidhur me Aktgjykimin **C.nr. 603/09**, të datës **29.07.2013** i cili kërkon ndryshimin e këtij Aktgjykimi dhe kërkon që Padia e Paditësit të aprovohet në tërësi. (**Ankesa e Ilijaz Bulecit është përfshirë në raportin e tremujorit Korrik-Shtator**).

Me datë **17.10.2013**, është bërë Përgjigje në Ankesë ndaj Paditësit **Vahid Kabashi**, lidhur me Aktgjykimin **C.nr. 745/05**, të datës **01.07.2013** i cili kërkon ndryshimin e këtij Aktgjykimi dhe kërkon që të vazhdon procesi i mëtejshëm në këtë çështje kontestimore.

Me datë **15.11.2013**, është bërë Përgjigje në Ankesë në Gjykatën Themelore në Prizren për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, **lidhur me lëndën C.nr. 1515/13**, të parashtruar nga Ankimuesi **Njazi Ademaj**, i cili i drejtohet **Gjykatës së Apelit në Prishtinë** nga që e konteston Aktgjykimin lidhur me kthimin e tij në punë pasi që i njëjti kërkon të kthehet në vendin e tij të punës Drejtor.

### GJYKATA SUPREME NË FAVOR TË KOMPANISË

Me datë **25.10.2013**, është sjellë nga **Gjykata Suprem** në Prishtinë **Aktgjykim lidhur me lëndën Rev.nr. 68/2013**, datë **02.10.2013**, me të cilin Refuzohet si i pabazuar Revizioni i paditësit Murat Brando nga Prizreni, i paraqitur kundër Aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr. 435/2011, datë 03.12.2012.

### VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE NË FAVOR TË KOMPANISË

Me datë 11.10.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Aktgjykim lidhur me lëndën C.nr. 567/10**, datë **19.04.2013**, me të cilin detyrohet Debitorja Igballe Dana, që ta paguaj borxhin ndj Kompanisë sonë në lartësinë e **45.80 €**, si dhe shpenzimet e procedurës.

Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Aktgjykim lidhur me lëndën C.nr. 430/11**, datë **11.07.2012**, me të cilin **Refuzohet si e pabazuar Padia e Paditësit Blerim Shala** nga Prizreni, ndaj ne si të Paditur të rendit të tretë, udhëzohemi që kompensimin për shpenzimin e ujit **ta kërkojmë nga e paditura e rendit të parë znj. Hylkije Juniku, e jo nga Paditësi Blerim Shala**.

Është sjellë nga Gjykata e Apelit në Prishtinë **Aktvendim lidhur me lëndën AC.nr. 5155/12**, datë **31.10.2012**, (**të Lëndës E.nr. 1385/12**) me të cilin **aprovohet (pjesërishtë) si e bazuar Ankesa e Kompanisë** sonë ndaj punonjësit **Gëzim Doda** lidhur me **Përmbarrimin** për kompensimin e të ardhurave personale lartësi prej **7.314.76 €**.

Është sjellë nga Gjykata e Apelit në Prishtinë **Aktvendim lidhur me lëndën C.nr. 223/2006**, datë **06.03.2013**, me të cilin **Hedhet poshtë si e paafatshme Ankesa e të Paditurit Imer Vorfaj** lidhur me borxhin në lartësi prej **278,24 €**, duke përfshirë edhe kamatën ligjore nga data e parashtrimit të Padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale.

## VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE KUNDËR KOMPANISË

Me datë **22.10.2013**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Aktgjykim lidhur me lëndën C.nr. 770/05**, datë **07.10.2013**, me të cilin Refuzohet si tërësisht e pabazuar Padia e Kompanisë (për borxh në lartësi prej **410.63 €**) ndaj Debitorit **Aziz Bytyqi**.

Me datë 24.10.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Aktvendim lidhur me lëndën C.nr. 768/05**, datë **21.10.2013**, me të cilin konsiderohet se Padia e Padiësit tërhiqet, (për borxh në lartësi prej **336.50 €**) pasi që Kompania sipas kërkesës së Gjykatës Themelore nuk ka mundur që ta gjej adresën e saktë të vendbanimit apo vendqëndrimit të Debitorit **Ajridin Avdo**.

Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Aktgjykim lidhur me lëndën C.nr. 189/06**, datë **18.10.2013**, me të cilin refuzohet si e pabazuar Kërkesëpadia e Padiësit K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A. në Prizren, ndaj Debitorit **Imer Bislimaj**, nën arsyetimin se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, nuk është provuar se këtu i padituri Imer Bislimaj, ka detyrime-borxh ndaj Padiësit, pasi që me vetëm një faturë nuk mund të provohet borxhi i pretenduar i Padiësit.

Me datë 21.11.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Aktgjykim lidhur me lëndën C.nr. 320/06**, datë **14.11.2012**, me të cilin Refuzohet si e pabazuar **Kërkesëpadia e Kompanisë** sonë ndaj Debitorit **Halil Sallauka** për borxhin në lartësi prej **335.28 €**.

Me datë 16.12.2013 është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Aktgjykim lidhur me lëndën C.nr. 424/06**, datë **03.12.2013**, me të cilin Refuzohet si e pabazuar **Kërkesëpadia e Kompanisë** sonë ndaj Debitorit **Eshref Krasniqi** për borxhin në lartësi prej **1.268,51 €**.

Me datë 18.12.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Aktgjykim lidhur me lëndën C.nr. 336/06**, datë **21.11.2013**, me të cilin Refuzohet si e pabazuar **Kërkesëpadia e Kompanisë** sonë ndaj Debitorit **Avni Jakupi** për borxhin në lartësi prej **943,02 €**.

## KONKLuzion

Me 02.10.2013, në seancë gjyqësore është kërkuar që Gjykata Themelore e Prizrenit të njoftohet nga Kompania Gjykata Themelore në Prizren lidhur me Adresën e saktë të Debitorit **Ajridin Avdo** lidhur me lëndën **C.nr.768/05**.

Me datë 03.12.2013 është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Aktvendim lidhur me lëndën C.nr. 793/06**, datë **29.11.2013**, me të cilin Gjykata Themelore gabimisht merr Vendim për kinse Padinë e tërhequr, pasi që ne i jemi përgjigjur me kohë kërkesës së Gjykatës lidhur me Adresën e Debitorit **Sadudin Kazazi**, Rr. "Saraçevë", nr. 5/a, në Prizren.

Me datë 26.12.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **Konkluzion lidhur me lëndën CP.nr. 645/13**, datë 23.12.2013, me të cilin Urdhërohet Kompania që në afat prej 30 ditësh ta njoftojë Gjykatën Themelore lidhur me Adresën e saktë të Debitorit **Petrit Nuhaj** nga Prizreni, në të kundërtën procedura e përmbarrimit do të pezullohet dhe veprimet e marra përmbarrimore do të anulohen.

## PËRGJIGJE NË KONKLuzionET E ARDHURA NGA GJYKATA

Me datë 02.10.2013, është dhënë Përgjigje në Konkluzionin e kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me lëndën **C.nr. 768/05**, me të cilin e njëjta njoftohet me Adresën e saktë të Debitorit **Ajridin Avdo** nga Prizreni.

Me datë 13.11.2013, është dhënë Përgjigje në Konkluzionin e ardhur nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me lëndën **CP.nr. 793/06**, datë 29.11.2013, me të cilin e njëjta njoftohet me Adresën e saktë të Debitorit **Sadudin Kazazi** nga Prizreni.

Me datë 30.12.2013, është dhënë Përgjigje në Konkluzionin e ardhur nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me lëndën CP.nr. 645/13, datë 23.12.2013, me të cilin e njëjta njoftohet me Adresën e saktë të Debitorit **Petrit Nuhaj** nga Prizreni.

### PROPOZIM PËR LEJIMIN E EKZEKUTIMIT SIPAS AKTGJYKIMIT

Me datë 11.10.2013, është bërë propozim për lejimin e ekzekutimit sipas Aktgjykimit për lëndën C.nr. 408/06, datë 23.04.2013, ndaj Debitorës Sadete Curri.

### PROPOZIM PËR LEJIMIN E EKZEKUTIMIT

Me datë 11.10.2013, është bërë propozim për lejimin e ekzekutimit për borxh në lartësi prej 505.89 € ndaj Debitorit Naze Ninaj, Rr. Drinit, pn. nga Prizreni.

### NDËRPRERËJET E PROCEDURAVE SI PASOJË E VDEKJES SË DEBITORËVE

Me datë 22.10.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim lidhur me lëndën C.nr. 243/06, datë 18.09.2013, me të cilin Ndërpritet kjo çështje Juridike Kontestimore (për borxh në lartësi prej 1022.69 €) pasi që Debitori Hysin Vllaço ka vdekur.

**Masat e ndërmarra nga Gjykata për Kundërvajtje në Prizren lidhur me Paditë e bëra nga KRU për kyqjen ilegale të konsumatorëve për periudhën kohore Tetor – Dhjetor 2013**

Gjatë periudhës kohore Tetor – Dhjetor 2013, nga Gjykata për Kundërvajtje e Prizrenit janë shqyrtuar gjithsej **10 (dhjetë) Kërkesa për kyqje ilegale.**

1. Për **1 (një)** Kërkesa është shqyrtuar **masa – hedhet poshtë;**
2. Për **9 (nëntë)** Kërkesa është shqyrtuar **masa e dënimit në të holla**, ku shuma totale e dënimeve e kap shifrën e **790 € (shtatëqindtë e nëntëdhjetë ) Euro.**

Tremujori i IV-të	Masa e qortimit	Hidhet poshtë	Masa e pezullimit	Masa e dënimit në Euro	Të kryera gjithsej	Shuma totale e dënimeve në E
<b>Tetor</b>	/	/	/	/	/	/
<b>Nëntor</b>	/	/	/	/	/	/
<b>Dhjetor</b>	/	1	/	9	/	790 €
<b>Totali</b>	/	1	/	9	/	790 €

Gjatë këtij tremujori janë shqyrtuar edhe Ankesat e konsumatorëve të cilat në total janë 156 (njëqindtë e pesëdhjetë e gjashtë) Ankesa të shqyrtuara dhe për të gjitha këto lëndë janë lëshuar Vendime.

### Paraqitja tabelare e Vendimeve të lëshuara nga Ankesat e konsumatorëve

Muaji	Sasia e Vendimeve të lëshuara	Vërejtje
<b>Tetor</b>	<b>65</b>	/
<b>Nëntor</b>	<b>35</b>	/
<b>Dhjetor</b>	<b>56</b>	/
<b>Totali</b>	<b>156</b>	/

#### 3.4 Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për korrik- shtator 2013

Gjatë kësaj periudhe tremujore, puna e Asistentëve të IT pranë Kompanisë kryesisht identifikohet me këto aktivitete dhe veprimtari: **Përshkrimi hyrës;**

Aktivitetet e punës së përditshme detalisht janë pasqyruar në raportet ditore të cilat plotësohen në fund të orarit të punës. Këto raporte janë të gatshme në çdo kohë të prezantohen para autoriteteve dhe udhëheqësve të Kompanisë.

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionimit optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka pas peshë dhe ndikim të veçantë.

#### Raporti

Ndihmë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.

Ndërhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 16 herë.

Ndërhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 18 herë.

Ndërhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 14 herë.

Ndërhyrje në nënjesitë (Shatërvan, Depo, Koagolatorë) : 28 herë.

Ndërhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 270 herë.

Përkujdesje për qasjen e kompanisë në rrjetin e internetit.

Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.

Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.

Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të kompanisë

Riparim harvderik dhe softverik të pajisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.

Mbikëqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe servisimeve të pajisjeve kompjuterike e pajisjeve të ngjashme teknike.

Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.

Kemi vendosë e re telefonike në Baze.

Jemi në kërkim të ofertave për server të ri

Kemi krijuar Arka të reja me qëllim të kryerjes së pagesave direkt nga programi NAV.

Janë kyçë në sistem të pagesave (databaze) të gjitha portoarkat e kompanisë në të gjitha njësite.

Janë hapur user-et (përdoruesit) për portoarkat e kompanisë.

Kam instaluar printerë të rinj në portoarka.

### **Komentet dhe vërejtjet**

Mikroserveret e vendosur nëpër njësi janë duke i përdorë si backup serverë.

Racku i sjelle nga USAID e që ka kushtuar 1000 Euro nuk është në shfrytëzim.

Zgjidhja e problemeve me kontraktorin. Kemi shumë vonesa në marrjen e pajisjeve që po i porosisim.

Zgjidhje e problemit me hapësirë.

Mungese e pajisjeve që porosisim nga ana e kontraktorit.

Ka mbetur Depo (Mulliri) pa e kyçë në database për shkak të mungesës së pajisjes VPN Router.

Ka mbetur portoarka ne komune (Malisheve) pa e kyqë në database për shkak të mungesës së paisjes VPN Router.

Kerkoj nje shkrese ku ndalohet sjellja e kompjutereve (paisjeve elektronike) personale ne zyren e IT-se.

### **Propozimet – kërkesat**

Marrja edhe futja ne funksion në bazë e mikroservereve.

Duhet gjetur hapësirë (dhome) e posaqme per vendosjen e te gjithë servereve ne te.

Jam përgatitë për shumë certifikime tjera të Cisco Systems dhe Microsoft Certifications, mirëpo për shkak të obligimeve tjera nuk po mund t'i mbuloj. Kërkesë tjetër kishte me qenë nëse kompania do m'i paguante certifikimet. Një certifikim Microsoft, kushton 80\$ mirëpo një Cisco 260\$.

Blerja e dy VPN Routereve për Depo, Portoarke ne Malisheve, dhe nje baterie per laptop. Keto paisje ende nuk jane sjelle nga kontraktori, ndersa porosia eshte bere para 3 muajve.

Blerja e nje Cisco Fireëall ASA per sigurimin e rrjetit te kompanise.

Shume kolege, sjellin kompjutere personal ne zyren e IT-se, kjo po me pengon ne kryerjen e detyrave te kompanise. Kerkoj nje shkrese ku me ndalohet rregullimi i paisjeve personale te punetoreve.

### **Raport rreth punës së Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë**

Për të vlerësuar gjendjen aktuale në lidhje me sigurinë në punë dhe mbrojtjen nga zjarri janë vizituar të gjitha njësitë e punës KRU " Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren shumica e objekteve të tyre nga ana Zyrtarit për sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit të punëtorëve ne pune i përkrahur dhe i shoqëruar nga Zyrtari i Zyrës Ligjore te Kompanisë dhe atë:

Me datë 24.10.2013 kemi vizituar Njësinë Punuese Malishevë dhe po të njëjtën ditë njësi të njëjtën ditë Njësinë Punuese të Suharekës .

Me datë 25.10.2013 është vizituar Njësia Punuese Dragash, dhe

Me datat 20,21,22.11.2013 dhe 03.12.2013, janë vizituar objektet e Njesisë Punuese të Prizrenit.

Për disa objekte tek të cilat nuk është kryer vizitë është kërkuar nga Udhëheqësit e Njësive Punuese të na i dërgojnë të dhënat lidhur me atë se në çfarë gjendje janë ato.

Pas kryerjes së vizitave janë bërë Procesverbale për secilën Njësi Punuese veç e veç lidhur me gjendjen në të cilën ndodhen dhe si dhe mangësitë të cilat janë vërejtur ku edhe janë dhënë propozime për mënjanimin e mangësive ekzistuese.

Procesverbalet i janë dorëzuar Udhëheqësve të Njësive Punuese në mënyrë që të mënjanohen mangësitë ekzistuese.

Gjithashtu me datë 25.11.2013, kemi kontaktuar me Inspektorët e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit - Sektori i Parandalimit nga Zjarri, Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Gjatë këtij kontakti kemi biseduar për trajnimin e punëtorëve (Rojtarëve dhe Kujdestarëve) lidhur me mbrojtjen nga zjarri, dhe lëshimin e certifikatave pas trajnimit.



Nga të njëjtit kemi marrë përgjigjen që ata drejtpërdrejtë nuk e kryejnë trajnimin, por për këtë ekzistojnë firma të licencuara dhe njëra nga ato është "EFEKTI" e cila përveç që kryen trajnimin për mbrojtje kundër zjarrit, gjithashtu e bënë edhe servisimin e Aparateve kundër zjarrit, si dhe trajnimin për përdorimin dhe punën me klor, ku pas aftësimit e njëjta e bënë lëshimin e certifikatave.

Trajnimi i punëtorëve mundë të kryhet në grupe, nëpër objektet ku punëtorët (Rojtarët dhe Kujdestarët) e kryejnë punën.

Pasi që punëtorët (Rojtarët dhe Kujdestarët) në këtë drejtim nuk janë trajnuar, dhe të gjitha Aparateve kundër zjarrit u ka skaduar afati.

## IV. AKTIVITETI I SHËRBIMIT FINANCIAR

### 4.1 AKTIVITETET - TETOR-DHJETOR-2013

Shërbimi financiar, në tremujorin e katërt ka pas aktivitete të shumta, më poshtë do t'i listojmë disa nga aktivitetet:

- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje,
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet;
- Rifreskimi i shënimeve; të pagueshmet dhe të arkëtueshmet
- Kontrollimi i borxheve të konsumatoreve dhe borxhet ndaj furnitorëve si dhe pagesa ndaj tyre.
- Përgatitja e raporteve mujore-tremujore; faturimi, inkasimi dhe shpenzimet; ZRRUK, etj
- Raportimet tre mujore dhe vjetor për MZHE për investimet kapitale të bëra nga ta.
- Takime me kryeshefin lidhur me performancën e mujit të kaluar të kompanisë si dhe takime me menaxherët e njësisë.
- Raportet ditore me shërbimet brenda departamentit të financave si dhe brenda ndërmarrjes;
- Përgatitjen e komisioneve për regjistrimin dhe barazimin e arkave, inventarit dhe stoqeve në depo
- Inkasimi në këtë tre mujor të katërt, në krahasim me tremujorin e tretë 2013, është dukshëm më i lartë. Sidomos në muajin e fundit të këtij tre mujorit, inkasimi ka qenë mbi 100 %. Gjithashtu edhe mbulueshmëria është mbi një (1), pra ky fund vit është më i kënaqshëm, në arritjen e performancave.

### Arsyeshmëria e shpenzimeve

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e IV të 2013, në krahasim me tremujorin e tretë, kanë qenë më të larta, gjithashtu edhe inkasimit ka qenë më i lartë dhe mbulueshmeria operative ka qenë mbi një. Më poshtë do t'i cekim disa nga arsyet dhe ndryshimet në disa nga pozicionet kryesore të shpenzimeve.

Së pari shpenzimet si total në këtë tre mujor janë më të larta, duke ditur se aktivitetet operative dhe investuese kanë qenë në rritje, gjë që ka ndikuar edhe në rritje të inkasimit në këtë tre mujor.

Në pozicionin e pagave edhe pse ka qenë numri I njëjtë I punëtorëve me tre mujorin e kaluar, kemi një rënje të shpenzimeve të tyre, nga angazhimi I punëtorëve për punë jashtë orarit ka qenë më I ulët.

Te shpenzimet e energjisë elektrike kemi një rritje të tyre, duke ditur se në këtë tremujor kemi shtuar edhe puse të reja burimeve të ujit, gjë që ka ndikuar direkt edhe në rritjen e energjisë elektrike.

Te pozicioni i derivative nuk kemi ndonjë ndryshim, nëse e shikojmë si mesatare këtë tre mujor më atë paraprak, kemi një shpenzim relativisht të njejtë.

Ndërsa te mirëmbajtja, kemi ndryshim të shpenzimeve, pra një rritje të vogël të tyre, në krahasim me tre mujorin e kaluar. Ngase kemi rritjen e burimeve të reja të ujit, ndërhyrjeve në rrjet etj, ka ndikuar edhe në rritje të shpenzimeve të mirëmbajtjes.

Pra, investimet tona janë duke vazhduar në gjetjen e burimeve të ujit dhe ndërtimin e rezervuarve të rinj të ujit, si ai i Baqevcit, në ripërtëritjen e rrjetit të ujit, etj.

## 4.2 RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE TM3-TM4 - 2013

### • NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	TM3-2013	TM4-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	4,480,398	3,437,810	(1,042,588)	-23.27
<i>Faturimi m3</i>	1,777,160	1,399,338	(377,822)	-21.26
<i>Faturimi nga uji €</i>	935,204.21 €	764,541.51 €	- 170,662.70 €	-18.25
<i>Faturimi- te tjera €</i>	14,201.18 €	10,162.61 €	- 4,038.57 €	-28.44
<i>Faturimi Total €</i>	949,405.39 €	774,704.12 €	- 174,701.27 €	-18.40
<i>Inkasimi nga uji €</i>	659,847.82 €	684,896.98 €	25,049.16 €	3.80
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	27,407.17 €	5,537.47 €	- 21,869.70 €	-79.80
<i>Inkasimi Total €</i>	687,254.99 €	690,434.45 €	3,179.46 €	0.46
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	29316	29512	196	0.67
<i>% e inkasimit</i>	70.56	89.58	19.03	26.97
<i>Shpenzimet</i>	592,380.39 €	635,444.56 €	43,064.17 €	7.27
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,703,238	2,038,472	(664,766)	-24.59
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	60.33	59.30	-1.04	-1.72
<i>Mbulimi operativ</i>	1.16	1.09	-0.07	-6.35

## PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE – TM3-TM4- 2013

### • NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	TM3-2013	TM4-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	481,206	503,840	22,634	4.70
<i>Faturimi m3</i>	238,473	191,486	-46,987	-19.70
<i>Faturimi nga uji €</i>	123,887.81 €	105,059.91 €	- 18,827.90 €	-15.20
<i>Faturimi- te tjera €</i>	8,834.11 €	2,894.95 €	- 5,939.16 €	-67.23
<i>Faturimi Total €</i>	132,721.92 €	107,954.86 €	- 24,767.06 €	-18.66
<i>Inkasimi nga uji €</i>	58,736.74 €	68,671.35 €	9,934.61 €	16.91
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	8,669.66 €	4,864.83 €	- 3,804.83 €	-43.89
<i>Inkasimi Total €</i>	67,406.40 €	73,536.18 €	6,129.78 €	9.09
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	4605	4737	132	2.87
<i>% e inkasimit</i>	47.41	65.36	17.95	37.87
<i>Shpenzimet</i>	80,672.36 €	97,202.67 €	16,530.31 €	20.49
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	242,733	312,354	69,621	28.68
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	50.44	61.99	11.55	22.90
<i>Mbulimi operativ</i>	0.84	0.76	-0.08	-9.46

## PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE – TM3-TM4- 2013

### • NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	TM3-2013	TM4-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	131,812	109,500	-22,312	-16.93
<i>Faturimi m3</i>	65,218	53,455	-11,763	-18.04
<i>Faturimi nga uji €</i>	40,741.72 €	35,205.51 €	- 5,536.21 €	-13.59
<i>Faturimi- te tjera €</i>	610.00 €	2,238.29 €	1,628.29 €	266.93
<i>Faturimi Total €</i>	41,351.72 €	37,443.80 €	- 3,907.92 €	-9.45
<i>Inkasimi nga uji €</i>	30,883.63 €	37,726.62 €	6,842.99 €	22.16
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	588.00 €	503.00 €	- 85.00 €	-14.46
<i>Inkasimi Total €</i>	31,471.63 €	38,229.62 €	6,757.99 €	21.47
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	1103	1116	13	1.18
<i>% e inkasimit</i>	75.80	107.16	31.36	41.37
<i>Shpenzimet</i>	27,306.23 €	27,459.22 €	152.99 €	0.56
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	66,594	56,045	(10,549)	-15.84
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	50.52	51.18	0.66	1.31
<i>Mbulimi operativ</i>	1.15	1.39	0.24	20.80

## PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE – TM3-TM4- 2013

• NJËSIA PUNUESE -  
MALISHEVË

MUAJI	TM3-2013	TM4-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	362,556	347,547	-15,009	-4.14
<i>Faturimi m3</i>	146,039	131,554	-14,485	-9.92
<i>Faturimi nga uji €</i>	81,616.92 €	75,310.97 €	- 6,305.95 €	-7.73
<i>Faturimi- te tjera €</i>	1,607.61 €	1,865.74 €	258.13 €	16.06
<i>Faturimi Total €</i>	83,224.53 €	77,176.71 €	- 6,047.82 €	-7.27
<i>Inkasimi nga uji €</i>	62,310.28 €	53,763.97 €	- 8,546.31 €	-13.72
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	2,706.38 €	2,801.43 €	95.05 €	3.51
<i>Inkasimi Total €</i>	65,016.66 €	56,565.40 €	- 8,451.26 €	-13.00
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	3467	3513	46	1.33
<i>% e inkasimit</i>	76.34	71.39	-4.96	-6.49
<i>Shpenzimet</i>	59,908.68 €	73,888.09 €	13,979.41 €	23.33
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	216,517	215,993	(524)	-0.24
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	59.72	62.15	2.43	4.07
<i>Mbulimi operativ</i>	1.09	0.77	-0.32	-29.46

## PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE – TM3-TM4- 2013

### • HIDROREGJIONI JUGOR - TM3- TM4-2013

MUAJI	TM3-2013	TM4-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	5,455,972	4,398,697	(1,057,275)	(19.38)
<i>Prodhimi - l/sec</i>	694	559	(134.5)	(19.38)
<i>Faturimi m3</i>	2,226,890	1,775,833	(451,057)	(20.26)
<i>Faturimi l/sec</i>	283	226	(57)	(20.26)
<i>Faturimi nga uji €</i>	1,181,450.66 €	980,117.90 €	- 201,332.76 €	(17.04)
<i>Faturimi- te tjera €</i>	25,252.90 €	17,161.59 €	- 8,091.31 €	(32.04)
<i>Faturimi Total €</i>	1,206,703.56 €	997,279.49 €	- 209,424.07 €	(17.36)
<i>Inkasimi nga uji €</i>	811,778.47 €	845,058.92 €	33,280.45 €	4.10
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	39,371.21 €	13,706.73 €	- 25,664.48 €	(65.19)
<i>Inkasimi Total €</i>	851,149.68 €	858,765.65 €	7,615.97 €	0.89
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	38491	38878	387	1.01
<i>% e inkasimit</i>	68.71	86.22	17.51	25.48
<i>Shpenzimet</i>	760,267.66 €	833,994.54 €	73,726.88 €	9.70
<i>Paga bruto</i>	423,741.79 €	415,413.55 €	- 8,328.24 €	(1.97)
<i>Mirmba. dhe riparimet</i>	55,649.51 €	66,626.96 €	10,977.45 €	19.73
<i>Rryma elektrike</i>	164,857.60 €	233,201.21 €	68,343.61 €	41.46
<i>Shpenzi. e derivateve</i>	22,724.84 €	27,178.25 €	4,453.41 €	19.60
<i>Kemikalet</i>	5,422.26 €	1,075.05 €	- 4,347.21 €	(80.17)
<i>Shpenzi. tera operat.</i>	87,873.65 €	90,499.52 €	2,625.87 €	2.99
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	3,229,082	2,622,864	(606,218)	(18.77)
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	59.18	59.63	0.44	0.75
<i>Uji I pafaturuar l/sec</i>	410.70	333.60	-77.10	(18.77)
<i>Mbulimi operativ</i>	1.12	1.03	-0.09	(8.02)



## V. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM

Raporti në vijim paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të ndërmarra të auditorit të brendshëm, për periudhën kohore tetor - dhjetor 2013.

Për të gjitha aktivitetet e ndërmarra, ekzistojnë raporte të përgaditura me shkrim, mirëpo ky raport shkurtimisht paraqet një kronologji të aktiviteteve tremujore të ndërmarra.

Në pajtim me planin vjetor të paraparë, janë bërë auditime në disa subjekte audituese, sikurse në:

- departamentin e financave,
- departamentin teknik,
- shërbimin me konsumatorë, dhe në
- zyren e prokurimit.

Fusha e auditimit ka qenë:

- Menaxhimi i procedurave të prokurimit,
- Menaxhimi i planit vjetor të biznesit;
- Menaxhimi i procesit të vlerësimit të punonjësve;
- Menaxhimi i transportit - automjeteve zyrtare, dhe
- Menaxhimi i depozë – stoqeve.

Pas përfundimit të auditimeve dhe testimeve të nevojshme, në pajtim me procedurat e punës së auditimit është bërë:

- përgatitja e draftraporteve për të gjitha auditimet e lartpërmendura,
- mbajtja e takimeve me subjektet e audituara dhe diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe
- finalizimi i raporteve.

Poashtu gjatë kësaj periudhe është bërë edhe një auditim gjithëpërfshirës në subjektet që janë audituar gjatë këtij viti si dhe është bërë rishikimi i rekomandimeve si dhe niveli i implementimit të tyre. Lidhur me këtë gjatë muajit janar është përgatitur një raport detal me të gjitha shënimet dhe informatat e nevojshme.

**STRUKTURA ORGANIZATIVE**  
**KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN**

